



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SKEMA E GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR – MASA 2

Udhëzues për aplikim: Thirrje publike për përkrahjen e bizneseve prodhuese - Mbështetje për masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve – Masa 2.

Autoriteti zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë.

Autoriteti kontraktues: Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor (LuxDev).

1. Hyrje

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Ministria e Ekonomisë (ME) dhe Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor (LuxDev), më datë 10.09.2025 kanë nënshkruar marrëveshjen për skemën e granteve për energji të pastër. Qëllimi i kësaj skeme është të stimulojë angazhimin e sektorit privat në tranzicionin energjetik të Kosovës duke përdorur teknologji të qëndrueshme të prodhimit, duke rritur eficiencën e energjisë dhe duke ulur kostot operative.

Në këtë skemë ftohen Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim të bëhen pjesë e Skemës së Granteve për Energji të Pastër. Përveç tyre, të drejtë aplikimi kanë edhe bizneset e mëdha që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Vlera totale e skemës është 1 milionë¹ euro e financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

2. Qëllimi

Skema e Granteve për Energji të Pastër bashkëfinancon investime që përmirësojnë performancën energjetike dhe ulin kostot e energjisë elektrike përmes: (i) gjenerimit të energjisë së ripërtërishme (sistemet solare fotovoltaike dhe termike), (ii) ruajtjes së energjisë elektrike nga sistemet solare fotovoltaike përmes baterive, (iii) masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve, dhe (iv) pajisjeve që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Fokus i veçantë do t'u jepet ndërmarrjeve më të prekura nga tregu i hapur i energjisë elektrike, projektet e të cilave synojnë të rrisin eficiencën e energjisë dhe përdorimin e energjisë së ripërtërishme.

¹ Autoriteti Kontraktues (AK) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet e disponueshme.

3. Sektorët

Skema synon të mbështesë të gjitha Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM2) dhe bizneset e mëdha që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim.

4. Masat e mbështetura në kuadër të Grant Skemës për Energji të Pastër

Skema e Granteve për Energji të Pastër zbatohet përmes tri thirrjeve të veçanta publike, të cilat përfshijnë masat e mëposhtme:

- Masa 1: Mbështetje për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike.
- Masa 2: Mbështetje për masat e efijencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve.
- Masa 3: Mbështetje për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Aplikuesit mund të aplikojnë për secilën nga tri Masat (Masa 1, 2 ose 3) individualisht, me një mbështetje maksimale deri në 20,000 € për secilën Masë të vetme. Masa 1 dhe 2 mund të kombinohen secila me Masën 3, por në këtë rast mbështetja totale nuk mund të kalojë vlerën prej 25,000 EUR. Megjithatë, përfituesit nuk mund të përfitojnë njëkohësisht nga Masa 1 dhe Masa 2. Informatat në lidhje me shumat e granteve të ndara për secilën prej masave gjenden në Tabelën 1.

Skema e Granteve për Energji të Pastër	Vlera e grantit	Financuar nga granti	Informata shtesë
Masa 1: Mbështetja për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike.	€ 20,000	Sisteme solare (FV): 100 €/kWp Bateri për ruajtje të energjisë: 130 €/kW Sisteme solare termike: 40% e investimit total (deri në 300 €/m ² të sipërfaqes me panele solare).	Mund të kombinohet me Masën 3. Mbështetja maksimale për masat e kombinuara: € 25,000.
Masa 2: Mbështetja për masat e efijencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve.	€ 20,000	30% e shumës totale të investimit	Mund të kombinohet me Masën 3. Mbështetja maksimale për masat e kombinuara: € 25,000.
Masa 3: Mbështetja për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.	€ 20,000	70% e vlerës së pajisjes dhe deri në 65 €/kW.	Mund të kombinohet me Masën 1 ose 2. Mbështetja maksimale për masat e kombinuara: 25.000€.

Tabela 1: Masat e mbështetura dhe shuma e granteve të ndara për secilën prej masave

² Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-220

MASA 2: MBËSHTETJE PËR MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESAT E BIZNESEVE

Masa 2 e Skemës së Granteve të Energjisë së Pastër mbështet investimet në zbatimin e masave të efijencës së energjisë në détreasat e bizneseve.

Masat e Efijencës së Energjisë përfshijnë masat në mbështjellësin e jashtëm të ndërtesës, specifikuat:

- a) Termoizolimin e mureve të jashtme,
- b) Termoizolimin e kulmit, dhe
- c) Ndërrimin e dritareve dhe dýerve të jashtme.

Specifikimi i pozicioneve për masat e efijencës së energjisë dhe vlera e çmimit njësi janë dhënë në Shtojcën 1. Subvencionohet 30% e kostos së investimit, e kufizuar në shumën maksimale prej 20,000 €³, për zbatimin e masave të efijencës së energjisë. Shuma e subvencionimit varet nga paramasa dhe paralogaria e aprovuar nga Komisioni Vlerësues, për masat të cilat paraprakisht auditori i energjisë i ka konfirmuar në raportin e auditimit të detajuar të energjisë⁴.

Aplikuesit që kualifikohen: Për t'u kualifikuar për grantin, aplikuesit duhet të plotësojnë të gjitha kushtet në vijim:

- i. Të jetë i regjistruar si ndërmarrje e sektorit privat, nga 1 janari 2024 ose më herët, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ii. Të jetë kompani prodhuese ose përpunuese⁵ (domethënë prodhues, jo tregtar ose ofrues shërbimesh).
- iii. Të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme prodhuese ose përpunuese kualifikohen⁶ për aplikim. Gjithashtu, të gjitha kompanitë prodhuese ose përpunuese që nuk furnizohen më nga tarifa e rregulluar e energjisë elektrike, kualifikohen për këtë thirrje.

Shuma maksimale e grantit të alokuar për Masën 2 është **20,000 €**. Aplikuesit mund të kombinojnë Masën 2 me Masën 3, por shumata maksimale e grantit nuk mund të kalojë **25,000 €**. Granti i dedikohet vetëm aktiviteteve prodhuese/përpunuese.

Masa 2	Përshkrimi	Shuma maksimale e grantit	Kërkesat
a) Termoizolimi i mureve të jashtme, b) Termoizolimi i kulmit,	Për të përmirësuar efijencën e energjisë në	30% e shumës totale të investimit dhe deri në 20,000 €.	Aplikanti mund të aplikojë vetëm për një ndërtesë biznesi. Gjendja e ndërtesës:

³ Pavarësisht përqindjes 30%, vlera maksimale e subvencionit është 20,000 €. Shuma individuale e subvencionit llogaritet në bazë të sasive të verifikuara (nga kompania verifikuese) dhe kostove aktuale të bëra/paguara sipas faturës së detajuar dhe të paguar përmes transfertës bankare, duke mos tejkaluar çmimin e njërive referente të përcaktuara në këtë thirrje.

⁴ Paramasa/paralogaria (PP) përfshinë çmimin për njësi për çdo masë të propozuar të Efijencës së Energjisë. Çmimet referente përfaqësojnë koston për njësi që përfshijnë: materialet, instalimin/montimin, zëvendësimin, logistikën dhe çdo punë tjetër të ndërlidhur me finalizimin dhe funksionalizimin e masave. Fatura e detajuar duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përshkruajë në mënyrë eksplicite çmimin për njësi të materialeve, sasinë, koston e punës dhe shpenzimet logjistike siç specifikohet në PP.

⁵ Të gjithë sektorët me aktivitete parësore dhe dytësore në prodhim dhe përpunim.

⁶ Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-220.

c) Ndërrimi i dritareve dhe dyerve të jashtme.	ndërtesat e bizneseve.		○ Për aplikim në të gjitha masat e EE: Ndërtesa nuk duhet të ketë izolim termik ekzistues në muret e jashtme, kulm, si dhe dyer dhe dritare të vjetra dhe/apo joeficiente. ○ Për aplikim në masa të përzgjedhura specifike (p.sh. ndërrim dritaresh, dyersh, izolim kulmi): ndërtesa duhet të ketë izolim ekzistues në muret e jashtme, dhe vlera e koeficientit të transmetueshmërisë termike (U) e llogaritur për murin e jashtëm duhet të jetë më e vogël se $0.35 \text{ W/m}^2\text{K}$⁷.
--	------------------------	--	---

Tabela 2: Shumat maksimale të grantit për Masën 2.

5. Aplikimi

Procesi i aplikimit është i ndarë në dy (2) faza:

Faza 1: Parakualifikimi

1. Aplikacionet dorëzohen online përmes platformës e-Kosova duke bashkangjitur të gjitha dokumentet së bashku me Raportin⁸ e auditimit të thjeshtë të energjisë të hartuar pas datës së shpalljes. (seksioni 5.1: Dokumentet e kërkuara – Faza 1). Linku: <https://ekosova.rks-gov.net/714>
2. Komisioni i Vlerësimit verifikon dokumentet dhe zbaton kriteret e vlerësimit me pikë (seksioni 6.3).
3. Aplikuesit njoftohen për rezultatet e vlerësimit përmes platformës e-Kosova.
4. Lista e aplikuesve që janë vlerësuar me më së shumti pikë dhe janë parakualifikuar për grant publikohet në faqen e internetit të KIESA-s.
5. Aplikuesit e parakualifikuar nënshkruajnë kontratën për grant.

Faza 2: Disbursimi final për aplikuesit e parakualifikuar

1. Pas nënshkrimit të kontratës së grantit, aplikuesi duhet të angazhojë një kompani për zbatimin e masave të EE, bazuar në paramasë dhe paralogari të bashkëngjitur me raportin e auditimit të thjeshtë të energjisë. Në këtë fazë kërkohet gjithashtu edhe marrja e lejes ndërtimore apo pëlqimit komunal për renovim.
2. Pas përfundimit të punimeve, të gjitha dokumentet e kërkuara të Fazës 2 dorëzohen në MINT për komisionin monitorues.
3. Kompania verifikuese angazhohet nga LuxDev, për të inspektuar nëse pas kryerjes së punimeve nga përfituesit, masat janë realizuar⁹ sipas kriterëve të thirrjes dhe sipas paramasës dhe paralogarisë së bashkëngjitur me raportin e auditimit të thjeshtë të energjisë.

⁷ Kusht i detyrueshëm për masa të përzgjedhura: Izolimi termik i mureve të jashtme me vlerë $U < 0.35 \text{ W/m}^2\text{K}$ është kriter bazë dhe i domosdoshëm. Nëse nuk plotësohet ky kusht, masat e tjera të EE nuk do të aprovohen.

⁸ Raporti i thjeshtë i auditimit duhet të përfshijë përshkrimin e gjendjes ekzistuese, masat e rekomanduara, kalkulimin e kursimit të energjisë para dhe pas zbatimit, si dhe paramasën dhe paralogarinë me koston e vlerësuar për secilën masë.

⁹ Në rast se kompania verifikuese dëshmon se aplikuesi nuk i ka zbatuar masat sipas kushteve të kësaj thirrjeje, LuxDev rezervon të drejtën e anulimit të disbursimit edhe pas nënshkrimit të kontratës për grant.

4. Komisioni i Monitorimit shqyrton dokumentacionet e bashkangjitura dhe njofton aplikantët për rezultatet brenda afateve zyrtare.
5. Pagesa përfundimtare transferohet vetëm pasi të jenë dorëzuar dhe shqyrtuar të gjitha dokumentet e kërkuara.

5.1. Dokumentet e kërkuara

Faza 1 (përmes e-Kosova)

Nr.	Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018	Faza 1
1.	Certifikata e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.	☐
2.	Certifikata e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).	☐
3.	Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.	☐
4.	Lista e punëtorëve për vitin 2024, të lëshuar nga ATK, me emrin e ndërmarrjes e në harmoni me NUI (mund të shkarkohet online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës, do të kategorizohen dhe vlerësohen NMVM-të, si dhe do të vlerësohen pikët e punësimit të gjinisë femërore.	☐
5.	Kopja e letërnjoftimit të personit në emër të së cilit/ës është i/e regjistruar ndërmarrja.	☐
6.	Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.	☐
7.	Dëshmia e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes.	☐
8.	Gjendja e xhirollogarisë bankare në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2024).	☐
9.	Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).	☐
10.	Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).	☐
11.	Për ndërmarrjet e regjistruara para vitit 2023, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2023 dhe 2024 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2023 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi.	☐
12.	Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit, strukturën organizative të aplikuesit, ndikimin në performancën e ndërmarrjes, dhe aplikimin e energjisë së ripërtërishme dhe ekonomisë së gjelbër, duhet të shkarkohet nga webfaqja e KIESA-s, të përgatitet nga subjekti aplikues dhe të ngarkohet në platformën e-Kosova.	☐
13.	Aplikacioni, duhet të plotësohet online në eKosova.	☐
Dokumentet e kërkuara për plotësimin e kriterëve teknike		
14.	Dëshmi se ndërtesa ka leje ndërtimore, certifikatë legalizimi, ose certifikatë përdorimi.	☐

15.	Dëshmi mbi pronësinë apo të drejtën e përdorimit të ndërtesës: Fletë poseduese ose certifikatë pronësie, ose kontratë qiraje afatgjatë (minimum 7 vjet) e noterizuar.	☐
16.	Raporti i auditimit të thjeshtë të energjisë të hartuar pas datës së shpalljes, i cili duhet të përfshijë përshkrimin e gjendjes ekzistuese, masat e rekomanduara, kalkulimin e kursimit të energjisë para dhe pas zbatimit, si dhe paramasën dhe parallogarinë me koston e vlerësuar për secilën masë.	☐
17.	Konsumi total i energjisë elektrike 2024 (EUR dhe kWh) (dokument nga furnizuesi KESCO ose furnizues të tjerë).	☐
Dokumentet e kërkuara për pikë shtesë		
1.	Kontrata ¹⁰ e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët në treg të hapur.	☐
2.	Certifikata ¹¹ e lindjes e pronarit, bashkëpronar-it ose udhëheqësit (përdoret për të vërtetuar se personi i regjistruar si pronar, bashkëpronar ose udhëheqës i kompanisë është grua).	☐

Faza 2

Nr.	Dokumentet e kërkuara	Faza 2
1.	Fatura(t) e rregullta me dëshmi pagese përmes transferit bankar, të detajuara sipas pozicioneve të masave të EE që janë zbatuar dhe të korrespondojnë me përshkrimin e masave në paramasë dhe parallogari, si pjesë përbërëse e dokumentacionit të bashkëngjitur në fazën 1 (data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes, përkatësisht nga data 15 shtator).	☐
2.	Deklarata nga kompania implementuese që punët janë kryer konform kriterëve teknike të specifikuar në thirrje.	☐
3.	Dëshmi mbi marrjen e pëlqimit komunal ose lejes ndërtimore nga komuna përkatëse për projektin e propozuar për zbatimin e masave të EE (renovim).	☐

5.2. Zbatimi i punimeve

Aplikuesi duhet të kontrakttojë kompaninë punëkryese për të zbatuar masat e eficiencës së energjisë. Punëkryesi duhet ta sigurojë aplikuesin që puna kryhet nga një personel kompetent i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme për secilin pozicion të punës, dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës sipas standardeve përkatëse teknike. Punimet kërkojnë të përmbushin objektivin e përgjithshëm të investimit, duke u siguruar që materialet e instaluar të përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara në paramasë dhe parallogari.

5.3. Auditorët e Energjisë

Aplikuesi mund të zgjedhë një auditor të energjisë nga lista ekzistuese e publikuar e auditorëve në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë: <https://me.rks-gov.net/energija/>

Raporti i auditimit të energjisë në formë elektronike mund të shkarkohet nga uebfaqja e KIESA. Auditori i çertifikuar i energjisë duhet të kryejë inspektimin e ndërtesës për të cilën aplikon biznesi për të analizuar gjendjen ekzistuese dhe duhet të ofrojë rekomandime për aplikimin e masave të

¹⁰ Nëse nuk dorëzohet, konsiderohet se kompania përfiton nga tarifat e rregulluara të energjisë elektrike (0 pikë për kategorinë 1).

¹¹ Nëse nuk dorëzohet, konsiderohet se kompania nuk është në pronësi, bashkëpronësi ose nuk udhëhiqet nga një grua (0 pikë për kategorinë 4).

nevojshme të efijencës së energjisë.

Auditori duhet të kryej shërbimet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Në kuadër të këtij projekti, auditori i energjisë që ka qenë i përfshirë në hartimin e raportit të thjeshtë të energjisë gjatë fazës së aplikimit nuk lejohet të kryejë verifikimin e zbatimit të masave të EE në ndërtesat për të cilat ka realizuar auditimin.

Shpenzimet e auditimit merren përsiper nga vet aplikuesi dhe nuk kompensohen nga granti.

5.4. Verifikimi i punimeve të realizuara

LuxDev do të kontraktojë kompani konsulente për të verifikuar nëse aplikuesi ka përfunduar të gjitha masat e efijencës së energjisë sipas kriterëve të thirrjes dhe ka përdorur sasitë dhe materialet e duhura së bashku me çmimet referuese.

Kompania do të hartojë një raport verifikimi, i cili i dorëzohet Komisionit për të konfirmuar përputhjen e plotë të masave dhe për të rekomanduar disbursimin e grantit. Ky raport do të përcaktojë nëse zbatimi i masave është bërë në formë të pranueshme për disbursim.

Raporti përveç analizës teknike që përfshin inspektimin në terren për të verifikuar nëse sasitë e masave të zbatuara (metrat katrorë të secilit pozicion¹²) janë sipas kriterëve të specifikuar në thirrje, paramasës e parallogarisë dhe raportit të auditimit të thjeshtë të energjisë, do të përfshijë edhe analizën e dokumenteve financiare-faturave dhe transfereve bankare. Në bazë të kësaj analize teknike dhe financiare, përgatitet rekomandimi përfundimtar që i dorëzohet LuxDev për aprovimin e disbursimit të subvencionit.

Metodologjia e inspektimit të zbatimit të masave EE është si vijon:

- Matjet gjatësore duhet të bëhen me metër laserik ose/dhe me shirit metër.
- Matjet e trashësisë së shtresës izoluese duhet të bëhen me penetrim/shpim me shufër metalike të shkallëzuar në njësi matëse centimetër.
- Verifikimi i dritareve duhet të bëhet me matjen e trashësisë së profilit me nonius ose shirit-metër, ndërsa xhamosja në formë vizuale. Vendosija e shtresës low-e duhet inspektuar me pajisjen verifikuese adekuate.

Si përfundim, skicat e matjeve i prezantohen përfituesit. Nëse përfituesi pajtohet me rezultatet, skicat duhet të nënshkruhen nga ai. Komisioni kryen vlerësimin e realizimit të masave dhe shqyrtimin e dokumenteve financiare. Vetëm pas këtij procesi kryhet pagesa e subvencionit.

6. Rregullat dhe kushtet e përgjithshme

6.1. Sqarime shtesë

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Ndërmarrja përfituese pas instalimit të sistemit do të rimbursohet në bazë të pikës 3 të dhe 4 të këtij udhëzuesi.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe, pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.

¹² Aplikuesi nuk do të rimbursohet nëse ka realizuar një pozicion mirëpo nuk ka përmbushur kriteret minimale të përcaktuara në këtë thirrje.

- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur me pikë më të larta nga komisioni vlerësues varësisht mjeteve të planifikuara.
- Në rast të ndonjë kostoje të paparashikuar që lidhet me zbatimin e propozimit, biznesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e këtyre kostove.
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një shpenzim që nuk pranohet sipas kësaj Skeme për kompanitë që deklarojnë TVSH-në
- Nuk pranohen ndryshimet në ARBK nga momenti i hapjes së thirrjes dhe gjatë gjithë fazës së aplikimeve të thirrjes publike, si dhe për ndërmarrjet përfituese, pas shpalljes së listës preliminare deri te realizimi i pagesës.
- Aplikuesit kanë dy mundësi për të marrë grantin: përmes rimbursimit të plotë pas verifikimit përfundimtar, ose përmes një paradhënieje prej 50% të vlerës së grantit pas nënshkrimit të marrëveshjes, me kusht që të dorëzohet një garanci bankare për 50% të grantit, të lëshuar nga një Institucion Financiar i Regjistruar (RFI), i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Shuma e mbetur prej 50% paguhet pas dorëzimit dhe miratimit të plotë të dokumentacionit sipas kërkesave të Fazës 2.

6.2. Si të aplikohet?

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINT, KIESA dhe të ME:

- <https://mint.rks-gov.net/>
- <http://kiesa.rks-gov.net/>
- <https://me.rks-gov.net/>

Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës e-Kosova: <https://ekosova.rks-gov.net/714>

Afati për aplikim: nga data 10.10.2025 deri më datë 09.12.2025

Informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

6.3. Kriteret për vlerësim

Përfitues do të jenë ato biznese që janë renditur me pikët më të larta nga komisioni, në varësi të kufijve buxhetor. Vetëm lista e bizneseve përfituese të përzgjedhura do të publikohet në faqen e internetit të KIESA (<https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,134>).

Para se të zbatohen kriteret e vlerësimit me pikë, të përcaktuara në tabelën më poshtë, të gjitha aplikimet do t'i nënshtrohen fillimisht një shqyrtimi paraprak në Fazën 1. Ky shqyrtim do të verifikojë nëse dokumentet janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike për masën/masat e përzgjedhura. Aplikimet që nuk i plotësojnë këto kërkesa nuk do të kalojnë në fazën e vlerësimit me pikë.

Aplikimet që plotësojnë kërkesat e Fazës 1 do të vlerësohen dhe do të jepen pikët bazuar në kriteret e ponderuara të përshkruara më poshtë. Renditja përfundimtare do të përcaktohet në bazë të pikëve të përgjithshme të vlerësuara.

Vetëm aplikuesit që përzgjidhen pas procesit të vlerësimit me pikë do të vazhdojnë në Fazën 2. Në Fazën 2, përfituesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar siç përcaktohet në Thirrje dhe në kontratë. Komisioni do të verifikojë përmbushjen e të gjitha kërkesave para se të bëhen pagesat. Rimbursimi do të realizohet vetëm pasi të jenë verifikuar dhe miratuar të gjitha kriteret dhe dokumentet e Fazës 2.

#	Kriteret e vlerësimit	Përshkrimi	Pikët maksimale
1	Ekspozimi ndaj çmimeve të energjisë elektrike të bazuara në treg	Kompania nuk përfiton nga tarifat e rregulluara të energjisë elektrike.	deri në 45 pikë
2	Intensiteti ¹³ i energjisë (elektrike)	Niveli i intensitetit të energjisë (elektrike) në operacionet e biznesit.	deri në 20 pikë
3	Ndikimi ¹⁴ i energjisë (elektrike)	Ndikimi i kostove të energjisë (elektrike) në performancën e biznesit.	deri në 20 pikë
4	Përfshirja Sociale: Kompania: (a) është në pronësi, në bashkëpronësi ose udhëhiqet nga një grua (në pronësi ose bashkëpronësi), (5 pikë) (b) është në pronësi, në bashkëpronësi ose udhëhiqet nga minoritetet, (5 pikë) (c) punëson një numër të konsiderueshëm grash (të paktën 30% e stafit të përgjithshëm) (5 pikë)		deri në 15 pikë
#	Totali		deri në 100 pikë

Tabela 3: Kriteret e vlerësimit [me pikë]

6.4. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, në platformën e-Kosova.

Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, subjektit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbajë përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.

¹³ Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar konsumin total vjetor të energjisë elektrike (në kWh) gjatë vitit 2024 me qarkullimin total vjetor të biznesit (në euro) për të njëjtin vit.

¹⁴ Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar shpenzimet totale vjetore për energji elektrike (në €) gjatë vitit 2024 me fitimin operativ total vjetor të biznesit (në €) për të njëjtin vit.